



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 06

Datë: 15. 04. 2019. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Florian Dushi, Adnan Rrustemi, Nazlije Bala, Ercan Spat, Stevan Veselinoviq, Alfred Kinolli, Cemajl Kurtish.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef. Valmira Selmani (ZRPP).

Përkthyes: Vera Dula. **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

-Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve 04 dhe 05/2019

2. Raport i Këshillave të KQZ-së:

- Këshilli për Operacione Zgjedhore:

- Shqyrtimi dhe miratimi i emërimeve të anëtarëve të KKZ-ve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan (**shtyhet për mbledhjen e radhës...**)
- Shqyrtimi dhe miratimi i Specifikave teknike për shtypjen e fletëvotimeve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan;

3. Diskutim lidhur me rolin e OSBE-së, në zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan

4. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: Mirë se keni ardh...Rendin e ditës e keni para vetës. A ka dikush për të shtuar...?

Adnan Rrustemi: Në KOZ, i kemi shqyrtuar disa nominime për komisionet komunale zgjedhore në komunat ku janë shpallur zgjedhjet e jashtëzakonshme, dhe me kërkesën e këshillit që me u verifikuar disa prej të dhënave, qoftë për OJQ-të lokale që kanë bërë nominime mbi statusin ligjor të tyre, por edhe të personave të nominuar siq e parasheh ligji etj. Krye shefi, le të na konfirmoj se a kanë mbërri të verifikohen...?

Enis Halimi: Të nderuar anëtarë, ne kemi marrë veprimet në përputhje me kërkesat e dala nga mbledhja në KOZ, ne nuk kemi mundur ende ti procedojmë me garanca të kërkuara ligjore. Kërkojmë që kjo pikë të shtyhet, meqë bëhet fjalë për proces të ndjeshëm, dhe kohë të shkurtër...

Valdete Daka: A ka kjo efekt në operacionet e tjera...?

Enis Halimi: Jo, nuk ka implikim substancial në rrjedhën e procesit...

Florian Dushi: Në fakt, edhe nuk kemi zgjidhje tjetër. Gjithë ato që i kemi kërkuar në KOZ, janë të dhëna, informata që edhe pa ardhur në KOZ, ishte dashur që Sekretariati t'i kishte....!

Valdete Daka: Nëse pajtoheni që ta miratojmë rendin e ditës pa këtë pikë...?

Anëtarët e KQZ-së miratuan rendin e ditës.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve 04 dhe 05/2019

Valdete Daka: Vazhdojmë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve 04 dhe 05/2019, a ka vërejtje...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këto procesverbale.

4. Raport i Këshillave të KQZ-së

- Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe miratimi i Specifikave teknike për shtypjen e fletëvotimeve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan:

Adnan Rrustemi: KOZ, ka shqyrtuar specifikacionet teknike të shtypjes së fletëvotimeve. Ne kemi analizuar aspektin përmbajtësor dhe procedural. Nuk ka ndonjë dallim nga praktikat e kaluara. Fletëvotimi, është në përputhje me specifikat e kërkuara të sigurisë dhe aspekteve të tjera dhe ne, rekomandojmë që të miratohen. Bëhet fjalë për 87 Vendvotime, dhe secili vendvotim – maksimalisht do t'i ketë 950 fletëvotime...Numri i përafërt i fletëvotimeve që do të prodhohen, do të jetë: 58 000...

Valdete Daka: Ne, tradicionalisht, kemi shtypur më pak fletëvotime se numri i votuesve...?

Enis Halimi: Ne, formulën do ta propozojmë në mbledhjet e radhës, dhe po ashtu, dizajni final i fletëvotimit me emrat e kandidatëve kur mbaron procesi i konkurrimit, do të prezantohet edhe njëherë në mbledhje të ardhshme...

Adnan Rrustemi: Kjo, i paraprinë edhe rritjes së tavanit të fletëvotimeve...

Valdete Daka: Atëherë, kush është për miratimin e këtyre specifikave...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan specifikat teknike për shtypjen e fletëvotimeve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan.

5. Diskutim lidhur me rolin e OSBE-së, në zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan.

Valdete Daka: Në zgjedhjet e fundit 2017, ne kishim përfshirjen e OSBE-së në këto zgjedhje në pjesën veriore. Kësaj here, kemi zgjedhje vetëm në katër komuna, pra në pjesën veriore, dhe ne tradicionalisht kemi përfshirjen e OSBE-së vetëm në aspektin teknik, dhe atë për ditën e zgjedhjeve...Unë, konsideroj që ende ka nevojë që të përfshihet OSBE për këshilla teknike për KKZ-të dhe KVV-të...Pra, vetëm në ditën e zgjedhjeve... Nëse ka ndokush ndonjë pyetje, sugjerim...?

Adnan Rrustemi: Te kemi të qartë se këto zgjedhje, pavarësisht që janë të jashtëzakonshme dhe mbahen vetëm në katër komuna, duhet të jetë e qartë se KQZ është institucion kushtetues i përhershëm që organizon dhe mban të gjitha llojet e zgjedhjeve...Unë jam dakord që përvoja e OSBE-së ti shpërbej KQZ-së, mirëpo duke e qartësuar se OSBE as nuk e zëvendëson KQZ-në dhe trupat e saj që janë në këto komuna, por se bëhet fjalë vetëm për këshilla për KKZ-të dhe përkrahjen teknike të KVV-ve...Jam dakord, por që kjo të dihet...!

Pra, jemi dakord që të niset komunikimi, por nuk e shoh të arsyeshme të votojmë...

Sami Hamiti: Jo, vetëm dakordohem dhe, kryetari autorizohet nga ne të komunikojë...Njësoj si edhe në zgjedhjet e kaluara, dhe në parim jemi për...

Valdete Daka: Edhe me votuar, nuk shoh ndonjë pengesë...! Kush është për që unë të filloj komunikimin me OSBE-në, dhe Ambasadorit t'i dërgoj një letër...?

Anëtarët e KQZ, miratuan bashkëpunimin me OSBE-në për këto zgjedhje të Jashtëzakonshme për Kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan.

6.Të ndryshme.

Adnan Rrustemi: Kryetarja të vendosë komunikimin edhe me institucionet tjera të vendit, sidomos me policinë dhe institucionet e tjera relevante...

Valdete Daka: Unë, veç e kam filluar komunikimin, ashtu si edhe në zgjedhjet e tjera....Shihemi nesër, sepse do të kemi edhe nesër mbledhje...

